



PK. SH.A.  
Poste e Kosovës SH.A.  
Post of Kosovo J.S.C.  
Posta Kosova D.D.  
Nr./No./Br. 01-312/25  
Data/Date/Datum 19-02-2025  
PRISHTINE-PRISHTINA-KOSOVO

**Posta e Kosovës Sh. A.**  
**FILATELIA E POSTËS SË KOSOVËS**  
**RISHPALL KONKURSION**

**Për dizajne artistike të motiveve për dy pulla postare nga tematika "Personalitetet e shquara - Bashkim Fehmiu dhe Musa Shehzade" nga programi i rregullt tematik për vitin 2025**

1. Tematika e emisionit: **Personalitetet e shquara - Bashkim Fehmiu dhe Musa Shehzade**.  
Përshkrimi: Paraqitja artistike në pikturë, fotografi artistike, grafikë, etj..  
Shpërblimi: Vendi i parë €300, vendi i dytë €250.

**RREGULLAT E KONKURRIMIT:**

1. Dizajnet artistike (vizatim, pikturë, grafikë, fotografi artistike) të bazuara në këto tema duhet të punohen në programe të specializuara për dizajn si Adobe Photoshop, Illustrator, Corel Draw, të njëjtat duhet të dorëzohen të shtypura për nevoja të vlerësimit të komisionit, si dhe sipas nevojës në fajll kompjuterik.  
Punimet me rezolucion më të ultë se **500 px**. (TIFF, JPG ose PDF) nuk pranohen.
2. Për shkaqe të konfidencialitetit dhe objektivitetit, emri i autorit të dizajnit nuk duhet të shënohet pranë motivit konkurrues, aty duhet të shënohet vetëm shifra konkurruese, ndërkaq shënimet për autorin duhet të jenë të mbyllura në pliko të veqantë brenda plikos me punime konkurruese.
3. Komisioni i Pullës Postare, gjatë përzgjedhjes së dizajnëve, nuk do të ketë qasje në shënime autoriale, por ka të drejtë të kërkon verifikimin e origjinalitetit të dizajnëve potencialisht të përzgjedhur.
4. Dizajnet konkurruese për këtë konkurs duhet të dorëzohen në zarfe të mbyllura, duke shënuar temen/emisionin për të cilin konkuroni dhe shifren konkurruese.
5. Një autor mund të konkurojë me numër të pacaktuar të punimeve apo shifrave konkurruese.
6. Përgjegjësinë për të drejtat autoriale e mbart autori i dizajnit (konkurruesi).
7. Bazuar në: LIGJIN Nr. 04/L-065 PËR TË DREJTAT E AUTORIT DHE TË DREJTAT E PËRAFËRTA, autori fitues me dizajne të huazuara duhet patjetër të posedojë

- autorizimin me shkrim ose me e-mail nga autori i veprës origjinale, të cilën mund t'ia bashkëngjitë punimeve konkurruese ose ta dërgojë të skanuar në e-mail adresën: [filatelia@postakosoves.com](mailto:filatelia@postakosoves.com) dhe ta sjellë në "hard copy" në zyrën e Filatelisë.
8. PK Sh.A., mbanë të drejtën e përdorimit të dizajnit në motive të pullave postare ZDP, VDP si dhe në produkte fiatelike të ndërlidhura me pulla postare dhe shërbim postar.
9. Vlera e shpërblimeve për dizajne fituese është paraqitur si vlerë bruto.

**KONKURSI do të jetë i hapur 7 ditë kalendarike, prej datës: 20.02.2025 deri më 27.02.2025 dhe do të jetë i publikuar në ueb faqen: [www.postakosoves.com](http://www.postakosoves.com).**

Punimet konkurruese nuk do t'iu kthehen autorëve.

Zgjedhjen e punimeve më të mira konkurruese, duke u bazuar në dizajnin më të mirë dhe ndarjen e shpërblimeve, do ta bëjë Komisioni i Pullës Postare.

Punimet konkurruese mund ti dorëzoni në arkivin qendror të Postës së Kosovës, apo t'i dërgoni përmes letërdërgesave nga çdo zyre postare në adresë:

**Ndërtesa kryesore e Postës së Kosovës  
Arkivi qendror/ Për Konkurs-Filateli  
Rr."28 Nëntori" nr.4 Dardani  
10000 Prishtinë**

Për informata shtesë mund të thërrisni në numrin e telefonit: **+383(0)38 246 770**, apo të drejtoheni në e-mail adresën: [filatelia@postakosoves.com](mailto:filatelia@postakosoves.com), ose në ueb faqen zyrtare: [www.postakosoves.com](http://www.postakosoves.com).

Nora Rraci  
Kryeshefe Ekzekutive e PK Sh.A.



Posta e Kosovës SH.A.  
PK SH.A.  
PRISHTINË  
PRISHTINA  
Posta Kosovo J.S.C.